



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A
DREJTORIA TEKNIKE

Nr. _____, Prot

Vlorë, më ____ . ____ . ____

DETYRË PROJEKTIMI
MBI HARTIMIN E PROJEKTIT

OBJEKTI: “SISTEMI I MBLEDHJES SË UJRAVE TË NDOTURA NË ZONËN E DRIMADHES DHE IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA”

1. Hyrje dhe Nevoja për Projektim

Zona bregdetare e Palasës dhe Drimadhes përbën një nga hapësirat turistike me potencialin më të madh zhvillimor në Rivierën Jugore të Shqipërisë. Gjatë dekadës së fundit, kjo zonë ka përjetuar një rritje të konsiderueshme të investimeve turistike, me ndërtime të reja rezidenciale, hotele, resorte dhe struktura shërbimi të cilat gjenerojnë ngarkesa të rritura mjedisore, sidomos gjatë sezonit veror. Këto zhvillime, të kryera shpesh në mënyrë të pakoordinuar, e kanë vënë zonën në një presion të ndjeshëm mjedisor, për shkak të mungesës së një infrastrukture të unifikuar për kanalizimet e ujërave të ndotura dhe trajtimin e tyre përpara shkarkimit në mjedis.

Aktualisht, në një pjesë të konsiderueshme të zonës ekzistojnë rrjete të pjesshme të kanalizimeve ose projekte të pashoqëruara nga një koncept i përqendruar i mbledhjes dhe trajtimit. Këto rrjete shpesh shërbejnë zona të kufizuara të zhvillimit, pa u ndërlidhur me një sistem të përbashkët transferimi drejt impianteve ekzistuese të trajtimit. Si pasojë, kapacitetet e stacioneve të pompimit dhe kolektorëve kryesorë rezultojnë të pamjaftueshme për të përballuar prurjet potenciale të një sistemi të centralizuar.

Zona e Palasës dhe Drimadhes ka zhvillim të dendur turistik dhe rezidencial, me një popullsi sezonale që rritet gjatë muajve të verës. Kjo rritje sjell ngarkesa të konsiderueshme në rrjetet ekzistuese dhe në trupat ujorë pritës, duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen emergjente për ndërtimin e një sistemi të integruar të kanalizimeve dhe një impianti trajtimi që garanton mbrojtjen e mjedisit detar dhe nëntokësor.

Zona e studimit përshkon territorin e Drimadhes dhe pjesërisht të Palasës, duke përfshirë gjithashtu zonat veriore me zhvillim të ri turistik. Projekti synon hartimin e një koncepti të qëndrueshëm të

mbledhjes së ujërave të ndotura nga të gjitha nënbasenet (pellgjet ujëmbledhëse) dhe transferimin e tyre në një Impiant Trajtimi të Ujrave të Ndotura (ITUN) të ri, që do të projektohet në afërsi të përroit të Drimadhes, në bregun e majtë të tij, afër impiantit ekzistues.

Ky koncept synon:

- Krijimin e një rrjeti të unifikuar të kanalizimeve që përmbledh ujërat e ndotura nga të gjitha zonat e zhvilluara dhe ato në zhvillim.
- Verifikimin hidraulik të kapaciteteve ekzistuese të stacioneve të pompimit dhe kolektorëve, me qëllim adaptimin ose rehabilitimin e tyre.
- Projektimin e ITUN-it në dy faza: faza e parë për nevojat aktuale, dhe faza e dytë për zhvillimin afatgjatë të zonave të reja turistike.

Ky projekt paraqet një domosdoshmëri mjedisore dhe urbanistike për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës, për të parandaluar ndotjen e trupave ujqorë, rrezikun e kontaminimit të ujërave nëntokësore dhe ruajtjen e potencialit turistik të saj.

2. Qëllimi dhe Objektivat e Projektit

Qëllimi kryesor i këtij projekti është **projektimi i një sistemi të integruar për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura** për zonat bregdetare të **Palasës dhe Drimadhes**, në mënyrë që të sigurohet një zgjidhje e qëndrueshme mjedisore dhe teknike për përballimin e zhvillimit të shpejtë turistik në këto zona.

Ky projekt synon:

- **Hartimin e një skeme të përqendruar të kanalizimeve**, që do të bashkojë rrjetet ekzistuese dhe ato në zhvillim në një sistem të unifikuar për mbledhjen e ujërave të ndotura.
- **Projektimin e kolektorëve kryesorë dhe stacioneve të pompimit** në përputhje me kërkesat hidraulike të prurjeve aktuale dhe të perspektivës.
- **Projektimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN)** në afërsi të përroit të Drimadhes, të dimensionuar në dy faza: faza e parë për nevojat ekzistuese dhe faza e dytë për zhvillimin afatgjatë të zonave turistike.
- **Sigurimin e përputhshmërisë me Direktivën e BE-së për Ujërat e Ndotura Urbane (2024/3019)** dhe me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore.
- **Përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe të cilësisë së jetesës**, duke reduktuar ndotjen e trupave ujqorë dhe të ujërave nëntokësore.
- **Ruajtjen e potencialit turistik dhe të vlerave mjedisore** të zonave të Palasës dhe Drimadhes, përmes një infrastrukture moderne të trajtimit të ujërave të ndotura.

Ky projekt përbën një ndërhyrje prioritare për zhvillimin e qëndrueshëm të Rivierës Jugore, duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen e kapaciteteve infrastrukture me dinamikën e rritjes turistike.


3. Përshkrimi i Zonës së Studimit dhe Nën-Baseneve Ujëmbledhëse

Zona e studimit përfshin territorin bregdetar të Palasës dhe Drimadhes, të vendosura përgjatë rrugës kombëtare Himarë–Dhërmi–Palasë, në segmentin ku terreni kalon nga pllajat e buta bregdetare drejt shpateve më të pjerrëta të vargmalit të Vetëtimës. Topografia është karakterizuar nga relieve të valëzuara, me terraca natyrore dhe përrenj sezonalë që shkarkohen drejt detit Jon, duke ndarë zonën në disa nën-basene ujëmbledhëse të qarta hidrografikisht.

Zona ndodhet brenda Njësisë Administrative Himarë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, dhe përfshin zhvillime ekzistuese dhe të planifikuara turistike përgjatë vijës bregdetare. Të dhënat topografike dhe hidrografike të hartës bashkëlidhur tregojnë ndarjen e sistemit në tre nën-basene kryesore, që janë Nën-baseni 1, Nën-baseni 2 dhe Nën-baseni 4, të cilat përbëjnë objektin e fazës së parë të projektimit:

- Nën-baseni 1 (Zona 1) – përfshin pjesën perëndimore të Drimadhes, e kufizuar nga përroi kryesor që kalon në afërsi të ITUN ekzistues dhe rrugës lokale “Koçma–Kico Leka”. Sipërfaqja e kësaj zone është rreth 145 ha (Zona 1 + 1’+1’’). Kjo zonë përmban një densitet të lartë ndërtesash rezidenciale dhe struktura hotelerie në zhvillim, me terren që pjerrësohet butë drejt perëndimit.
- Nën-baseni 2 (Zona 2) – shtrihet në pjesën qendrore, përgjatë rrjetit rrugor lokal dhe zonave të akseve të zhvillimit turistik. Sipërfaqja e kësaj zone është rreth 10 ha. Gjeografikisht dhe topografikisht kjo zonë shkarkon në zonën e afërt 1’’ dhe me pas përgjatë kolektorit të bregdetit tashmë të ndërtuar.
- Nën-baseni 4 (Zona 4) – përfshin pjesën veriore të Drimadhes. Zona përbën një nën-basënë më të gjerë dhe më të pjerrët, me rrjedhje drejt përroit të Drimadhes në jug dhe drejt vijës bregdetare në perëndim.

Zonat e projektit janë prezantuar në figurë e mëposhtme:



ZONA E PROJEKTIT

4. Objekti i Punës së Konsulencës

Ky projekt ka për qëllim hartimin e projektit të plotë të sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe impiantit të trajtimit (ITUN) për zonat bregdetare të Palasës dhe Drimadhes, që përfshijnë zonat turistike ekzistuese dhe ato në zhvillim.

Projekti synon krijimin e një infrastrukture të unifikuar dhe të qëndrueshme, të përputhshme me kërkesat e Direktivës së BE për Ujërat e Ndotura Urbane (UWWT 2024/3019), duke garantuar mbrojtjen e mjedisit detar, nëntokësor dhe publik.

4.1. Zonat gjeografike dhe administrative të mbuluara

Projekti shtrihet në territorin administrativ të:

- Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, në kuadër të zonës së Njësisë Administrative Himarë, që përfshin vendbanimet dhe zonat turistike të Drimadhes, Palasës dhe segmentit verior të fshatit Dhërmi.
- Territori përfshin zonat turistike bregdetare dhe zonat e reja të zhvillimit në lartësi të mesme, të lidhura me rrjetin rrugor kombëtar dhe lokal, me prurje sezonale të larta gjatë verës.

Harta e studimit përcakton qartë tre nën-basene ujëmbledhëse (zonat 1, 2 dhe 4) që përbëjnë objektin e fazës së parë të projektimit, me shtrirje përkatëse në territorin midis përroit të Drimadhes dhe rrugës kombëtare Llogara–Himarë.

4.2. Komponentët kryesorë të projektimit

a) Studimi dhe verifikimi i rrjeteve ekzistuese

- Inventarizimi dhe analizimi i rrjeteve ekzistuese të kanalizimeve, përfshirë tubacionet, pusetat, kolektorët dhe stacionet e pompimit.
- Vlerësimi i kapaciteteve hidraulike dhe funksionale të sistemeve ekzistuese për t'u përshtatur me skemën e re të përqendruar.
- Identifikimi i pikave të ndërhyrjes për rehabilitim, lidhje ose zgjerim në funksion të sistemit të ri.

b) Projektimi i rrjeteve të reja të kanalizimeve

- Projektimi i kolektorëve kryesorë dhe degëve sekondare për grumbullimin e ujërave të ndotura në të gjitha nën-basenet (zonat 1, 2 dhe 4).
- Përcaktimi i dimensioneve dhe trasesë së tubacioneve, me analizë hidraulike për prurjet aktuale dhe të perspektivës (deri në vitin 2050).
- Projektimi i stacioneve të pompimit, linjave të presionit dhe strukturave ndihmëse (valvula, dhoma kontrolli, ventilim, akses).
- Parashikimi i lidhjeve të sistemit të ri me rrjetet ekzistuese dhe me impiantet aktuale të trajtimit për fazën kalimtare.

c) Projektimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN)

- Përgatitja e konceptit teknologjik të ITUN-it, i ndarë në dy faza të zhvillimit (fazë 1 për prurjet aktuale dhe fazë 2 për zhvillimin turistik të ardhshëm).
- Përcaktimi i kapacitetit të projektimit në banorë ekuivalentë (PE) dhe prurjet mesatare/maksimale ditore.
- Zgjedhja e procesit të trajtimit biologjik më efikas për kushtet klimatike dhe topografike (p.sh. sistem me ajrim të përzier, biofilm, MBR, ose proces hibrid).

- Projektimi i njësisve për trajtimin e llumit: stabilizim aerob/anaerob, dehidrim, kompostim dhe depozitim përfundimtar sipas kërkesave të VKM nr. 686/2015 dhe UWWT 2024.
- Parashikimi i monitorimit të parametrave të cilësisë së ujit (BOD₅, COD, SS, TN, TP) dhe sistemit të telemetrisë.

d) Projektimi i shkarkuesve në mjedis

- Projektimi i strukturës së shkarkimit të ujërave të trajtuara në detin Jon ose në përroit e Drimadhes, në përputhje me kërkesat mjedisore dhe kushtet hidrodinamike.
- Analiza e përhapjes dhe hollimit të ujërave të shkarkuara (dispersion modeling), me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me normat kombëtare dhe evropiane të emetimit.

e) Menaxhimi i ujërave të shiut

- Analiza e sistemeve ekzistuese të kullimit dhe ndarja funksionale midis ujërave të bardha dhe atyre të ndotura.
- Projektimi i strukturave të reja për mbledhjen dhe shkarkimin e ujërave të shiut, në përputhje me kërkesat e UWWT 2024 për menaxhim të përbashkët dhe parandalim të ndotjes difuze.
- Vlerësimi i nevojës për përpunim paraprak të ujërave të shiut përpara shkarkimit (p.sh. ndarës vaji, basene sedimentimi ose laguna).

f) Infrastrukturë ndihmëse dhe ndërvepruese

- Projektimi i rrugëve të shërbimit, ndriçimit, rrethimeve dhe impianteve elektrike për ITUN dhe stacionet e pompimit.
- Përfshirja e sistemeve të monitorimit dhe SCADA për kontroll në distancë të funksionimit të rrjetit dhe impiantit.
- Hartimi i planit të energjisë dhe eficiencës, duke përfshirë mundësinë e vetë-furnizimit nga burime diellore.

4.3. Dorëzimet kryesore

- Raport i **studimeve ekzistuese** dhe analizës së gjendjes aktuale.
- **Projekti paraprak dhe projekti i zbatimit** për rrjetet e kanalizimeve dhe ITUN.
- Vizatimet DWG, BOQ dhe **preventivat analitikë**.
- **Raport i vlerësimit mjedisor paraprak**, përfshirë studimin e shkarkimit dhe ndikimit në mjedis.
- **Plan fazimi dhe grafik pune** për realizimin e ndërtimit në faza.

5. Bazat e Projektimit dhe Standardet

Referencat ligjore e teknike:

- S SH EN 16933-2:2017 – projektimi hidraulik i kanalizimeve.
- Direktiva 2024/3019 e BE-së – kërkesat për trajtimin terciar/kuaternar, riciklimin dhe neutralitetin energjetik.
- Udhëzimet e AKUM, ERRU dhe MIE për kapacitetet e ITUN dhe normat e ngarkesave.

Përshkrimi i kriterëve të projektimit:

- Popullsia e projektuar (PE) për horizontet 2035 dhe 2050.
- Prurjet mesatare ditore dhe maksimale.
- Ngarkesat ndotëse (BOD₅, COD, SS, TN, TP).
- Kriteret për shkarkim në mjedis.

6. Studimet Paraprake të Nevojshme

Studime ndihmëse për realizimin e projektit do të jenë:

- Studimi topografik – rilevime të sakta për trasetë e rrjeteve dhe terrenin e ITUN-it.
- Gjeoteknikë dhe hidrogeologji – analiza e kushteve të ndërtimit dhe thellësisë së ujërave nëntokësore.
- Studim hidrologjik dhe klimatologjik – për llogaritjen e reshjeve, përmbytjeve dhe ndikimit klimatik.
- Analiza e cilësisë së ujit të detit/shkarkuesit për përcaktimin e standardeve të emetimit

7. Kërkesat për Projektin Teknik

Kërkesat për projektin teknik të sistemin e mbledhjes së ujërave të ndotura si minimum do të jenë:

- Planimetria dhe profilet gjatësore.
- Dimensionimi hidraulik (për rrjedhje gravitacionale ose të pompuara).
- Vendosja e pusëve, stacioneve të pompimit dhe strukturave ndihmëse.

Ndërsa për Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura:

- Kapaciteti i projektimit në PE dhe prurjet.
- Skema teknologjike e trajtimit.
- Menaxhimi dhe trajtimi i llumit (stabilizim, dehidrim, kompostim, pirolizë)
- Integrimi me sistemin e mbledhjes së llumit fekal nga zonat pa kanalizime.

8. Aspektet Mjedisore dhe Sociale

- Ndikimet mjedisore të parashikuara dhe masat minimizuese.
- Përputhshmëria me VKM nr. 686/2015 (për VNM) dhe Ligjin 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- Menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet dhe përgatitja e planit të emergjencës

9. Dorëzimet

- Raport i studimeve paraprake dhe fizibilitetit.
- Projekt paraprak dhe projekt zbatimi me vizatime DWG, BOQ, preventiv, analizë kosto–përfitim.
- Raportet mjedisore, të drenazimit dhe të energjisë.
- Grafik i zbatimit dhe plan i fazimit të ndërtimit.

10. Kërkesat për Koordinim Institucional

- Bashkërendimi me AKV, AKUK, Bashkinë dhe njësitë administrative përkatëse.
 - Marrja e miratimeve për:
 - Vendndodhjen e ITUN dhe shkarkuesit në det.
 - Përfshirjen në Planin Kombëtar të Ujërave të Ndotura.
 - VNM paraprake dhe lejen mjedisore.

11. Detyrat e përgjegjësitë e konsulentit

Në realizimin e objektivave për Studim Projektim në fjale, projektuesi menjherë mbas lidhjes së kontratës duhet të përgatis sipas nenit 37, të VKM.354, dt 11.05.2016 "Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit" sipas fazave të mëposhtme:

1. FAZA I -ANALIZA E DETYRËS SË PROJEKTIMIT
2. FAZA II -PROJEKT IDE PARAPRAKE
3. FAZA III -PROJEKT IDE PËRFUNDIMTARE
4. FAZA IV -PROJEKT PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT
5. FAZA VI -PREVENTIV PËRFUNDIMTAR

DETYRAT E DETAJUARA PËR KËTO TERMA REFERENCE JANË SIPAS FAZAVE

1. FAZA II

Përgatitja e raportit të projekt idesë paraprake dhe vizatimet e konceptit në lidhje me skemën e furnizimit me ujë e cila përmban (vend burimi i ujit, stacioni i pompave, depo e rezervimit të ujit, linja kryesore e dërgimt, zonat e furnizimit dhe pikat kritike).

Në këtë fazë, konsulenti do të përgatisë:

- Studimin e topografisë i cili përfshinë rilevimin e zonës,
- Studimin gjeologo - inxhinierik.
- Raportin e projekt idesë në lidhje me konceptin dhe gjetjet në terren; Skemën e propozuar për kalimin e linjave dhe zonave që do të mbuloj për furnizimin me ujë.
- Skema primare e furnizimit me ujë dhe skemen hidraulike të rigjeneruar nga modeli hidraulik
- Preventivin fillestar

2. FAZA III

Projekt ideja përfundimtare duhet të përfshijë minimalisht:

- Raportin teknik të projekt idesë përfundimtare, ku përfshihen llogaritjet, studimet, analizat e zgjidhjeve të dhëna dhe të tjera
- Vizatimet e zgjidhjes përfundimtare sipas sipas variantit të propozuar, ku të përfshinë minimalisht:
 - Horografia planimetria (1:10'000 ose 1:25'000);
 - Ortophoto planimetria (1:10'000 ose 1:5000);
 - Planimetria e linjës kryesore (bazuar mbi gjendjen ekzistuese ortophoto dhe rilevimin topografik), (1:1'000);
 - Skema primare e furnizimit me ujë
 - Profili gjatësor i linjës kryesore (1:1000H, 1:200V);
 - Preventivin;
 - Te bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor

3. FAZA V + FAZA VI,

Projekti i zbatimit dhe preventivi përfundimtar

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

- Vizatimet
 - Horografia planimetria (1:10'000 ose 1:25'000);
 - Ortophoto planimetria (1:10'000 ose 1:5'000);

- Planimetria e linjes kryesore (bazuar mbi gjendjen ekzistuese dhe rievimin topografik), (1:1000);
 - Skema primare e furnizimit me uje
 - Profili gjatesor te linjave kryesore (1:1000H, 1:100V);
 - Planimetria e pergjithshme e depos;
 - Preje dhe detaje te depos
 - Prerje dhe detaje te vend rojës dhe dhomës se klorinimit
 - Prerje dhe detaje te kabinës elektrike
 - Detaje te pikes se lidhjes ne depo
 - Detaje te terthoreve tip;
 - Detaje te nyjeve te rrjetit shperndares;
 - Detaje të intersektive dhe kalimeve (Tombino, Ura, Kanale, linja elektrike nentokësore dhe kanalizime) ne shkalle te ndryshme;
 - Detaje te pusetave (ajeruse dhe shkarkuese);
 - Relacioni teknik dhe logaritjet perkatese në anekse;
 - Në raportin teknik përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin. Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në gjendjen egzistuese, jepen llogaritjet hidraulike, llogaritjet e presioneve, llogaritja e veprave të artit, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, modeli kompjuterik i llogaritjeve me Water Gems ose te ngjashme, volumet, llogaritjet hidraulike të rrjeteve te ujësjellesit, etj. Në raportin teknik do të përfshihen raporti përfundimtar i studimit topografik, studimit gjeologjik, raporti hidrogeologjik e hidraulik, etj kur ato janë të nevojshme.
 - Relacioni dhe preventivi i kalimeve të rrugëve dhe carjeve të asfaltit në rrugët nacionale;
 - Jep në mënyrë të detajuar dhe të shpjeguar me harta ilustruese, vendet e kalimeve të rrugës nacionale, mënyrën e ndërhyrjes, menaxhimin e trafikut dhe kthimin në gjendjen fillestare si dhe preventivi i këtyre punimeve;
 - Specifikimet teknike;
 - Projektuesi duhet te përgatis specifikimet teknike per secilin nga materialet që do te perdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet te jepet:
 - Pershkrimi i detajuar i zërit të punes, materialet, cilësia e tyre, etj Metoda e kryerjes se punimeve;
 - Cilësia e kërkuar e punimeve;
 - Formatet e lejuara;
 - Ngjyra e rekomanduar;
 - Njësia e matjes, Etj.
 - Konsulenti duhet të ketë parasysh se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të percaktojë emrin e kompanisë që i prodhon.
 - Preventivi i punimeve (me dhe pa çmime) si dhe Analizat perkatese te çmimeve;
 - Preventivi per zbatimin e projektit :
 - Analizë teknike e çmimeve per te gjitha punimet e vlerësuara në preventive.
 - Zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknik te çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me zërbërthimin e çmimit (analizën perkatese) dhe t'i bashkëngjiten vlerësimit.
 - Vlera e preventivit përfundimtar nuk duhet të tejkaloj vlerën e perlllogaritur të investimit;
 - Preventivi të shoqërohet me tabelat e volumeve.
 - Grafik punimesh;
- Grafiku i punimeve të hartohet bazuar ne zërat e punës dhe teknologjinë e punimeve të shprehura ne Preventiv'

- Raporti per vlerësimin e ndikimit ne mjedis (VNM)
 - Raporti per vlerësimin e ndikimit ne mjedis duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011, VKM 686 29.07.2015 dhe akteve nënligjore perkatëse

12. Shërbimet e kërkuara

Grupi i projektimit është i detyruar të bashkëpunoj në mënyrë të ngushtë me Strukturat e Pushtetit Vendor si dhe me subjekte të tjera që paraqesin interes për zgjidhjen e projektit me qëllim për të siguruar azhornimet aktuale per paraqitjen e varianteve më të përshtatshme, për plotësimin me elementet e nevojshëm të infrastrukturës, për plotësimin e dokumentacionit të shpronësimeve dhe miratimet ligjore në organet perkatëse.

Gjithashtu Grupi i projektimit duhet të mbështetet dhe të konsultohet me studimet dhe Planin e Përgjithshëm Vendore të zonave të projektit.

Shërbimi i kërkuar do të përfshij por jo të limitohet në:

- Kryerjen dhe studimin e plotë për te gjetur alternativën tekniko-ekonomike-mjedisore më të mirë, sipas standardeve shiptare.
 - Analiza e detyrës së projektimit që do të përfshijë rekomandime të qarta per çdo fazë të hartimit të projektit.
 - Mbledhja, azhornimi dhe analizimi i rjetit te infrastrukturës me të gjitha të dhenat e nevojshme per projektim
 - Rilevimi i zonës per saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektimit që te evitohen pasaktesitë;
 - Hartimi i analizës së kostove dhe përfitimeve për secilin variant;
 - Kompletimi i projekt idesë përfundimtare për alternativat e përzgjedhura;
 - Trajtimi i projektit nga pikëpamja teknike (mjedisore, inxhinierike, gjeoteknike, ekonomike, etj.);
 - Paraqitja e një programi për realizimin e projekt idesë, projektit të zbatimit, dokumentacionin për tenderimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për leje ndertimi;

Grupi i projektimit sipas fazave te projektit te percaktuara më poshtë do te analizojë dhe te jape te dhena të hollesishme per shpronësimet e tokës apo objekteve duke dhenë te qarta kufijte e shpronësimeve dhe llogaritjet e siperfaqeve sipas pronarëve duke u mbeshtetur dhe bashkëpunuar me ASHK dhe Pushtetin Lokal.

Fazat e projektit do të jenë si më poshtë **Kategoria IV:**

Faza II. Projekt ideja paraprake 1-Muaj

Faza III. Projekt ideja përfundimtare; 2-Muaj

Faza V. Projekti i zbatimit; 3-Muaj

Faza VI. Preventivi përfundimtar; 2-Muaj

Secila nga këto faza duhet të bëhet në konsultim të vazhdueshëm me stafin e Autoritetit Kontraktor.

Koha e kërkuar për realizimin e shërbimit të mësipërm parashikohet 8 muaj.

13. Marrja në dorëzim

Marrja në dorëzim e produktit përfundimtar do të përmbaj, pa u limituar, elementët e mëposhtëm:

- Relacion teknik I hartuar dhe firmosur nga projektuesi me licensen përkatëse sëbashku me llogaritjet hidraulike(modelimi hidraulik) dhe konstruktive për vepren e marrjes, depo uji, tubacione, stacion pompimi, elektropompa
- Licenca e projektuesit
- Projekti në format A3
- Planimetria e zones ku ndohet objekti sëbashku me linjat ekzistuese të ujesjellesit/kanalizimeve
- Skema hidraulike ekzistuese e ujesjellesit/kanalizimeve
- Koorografia në shkallë 1:25000 ose 1:1000 në format A0
- Planimetria e linjave kryesore, dërgimit dhe rrjeteve shpërndarese në shkallë 1:1000 në format A3, planvendosja e kaptazheve, pushpimet, pushuarjet, depot e ujit etj.
- Profilat Gjatësore në shkallë 1:2000 1:1000 të shoqëruar me të dhënat hidraulike si $D(\text{mm})$, t_{mm} , $q=1/\text{sel}$, $v=\text{m/s}$, profilat tërthore
- Vijat piezometrike të linjave kryesore të furnizimit dhe të dërgimit 1:20 format A3
- Skema hidraulike e ujësjellësit/kanalizimit të projektuar në format A0
- Azhornimet e rrjeteve ekzistuese KUZ, Elektrike, Telefon, Telekom, fibra optike Ejt
- Specifikimet teknike të hartuara nga projektuesi sipas zërave të punimeve të parashikuara në projekt preventiv në format A4
- Projekti elektrik, tokëzimet, profilat gjatësore të linjes elektrike, detajet teknike etj I hartuar nga ing elektrik I licensuar
- Preventivi të hartohet sipas VKM Nr.216, Dt.13.04.2023 me cmimet e manualeve në fuqi dhe shoqëruar me analizat teknike të cmimeve, për cmimet që nuk parashikohen në keto manuale, të jetë në format A4
- Analiza e plotë kimike dhe baktoreologjike të ujit (burim, pushtim ujëra sipërfaqësor) të konfirmuara nga organet e specializuara në rreth ose nga Instituti I Shendetit Publik
- Studimi Gjeologjik I trasese ku do të kalojnë linjat e ujesjellesit dhe për veprat e marrjes depot e ujit
- Oponenca teknike kur objekti ka vlerë të preventivuar ≥ 100 milion lekë me TVSh sipas VKM Nr.1055 date 22.12.2010
- Vërtetim nga Bashkia për shpronësimet për zonën ku do të zbatohet projekti
- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
- CD e projektit